

ADOPTO DHE SHPËTO NJË JETË!

5 ARSYE PSE DUHET TË ADOPTONI NË VEND SE TË BLINI NJË KAFSHË

Shumë nga këlyshët apo kotelet e shitura në dyqanet e kafshëve ose në internet kanë origjinën nga qendrat mbarështuese (objektet komerciale për mbarështimin e kafshëve) që fokusohen në përfitime financiare pa marrë parasysh fare shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve.

Qendrat mbarështuese shpesh prodhojnë kafshë me probleme serioze shëndetësore, dhe kjo mund të nënkuptojë kosto të larta veterinare për kafshën tuaj të ardhshme dhe shqetësime të mëdha për ju dhe vet kafshën.

EDHE NË
MERITOJMË
NJË
SHTËPI



Adoptimi i një kafshe është një nga gjërat më të mira që mund të bëni ndonjëherë, si për kafshën ashtu edhe për veten tuaj. Për t'ju bindur, në vijim mund të gjeni **një listë me 5 arsye** pse duhet të adoptoni një **kafshë shoqëruese (qen, mace)** nga rruga apo strehimorja.

1 → SHPËTONI NJË JETË

Kjo është arsyeja kryesore. Kur adoptoni, ju i jepni një qeni apo mace një shans të dytë në jetë. Në jetën e tyre, disa mund të jenë abuzuar, braktisur ose janë detyruar të luftojnë për mbijetesë në rrugë. Duke adoptuar, ju i jepni qenit apo maces një shtëpi të sigurt dhe të dashur në të cilën mund të mësojë të jetë përsëri një kafshë e lumtur dhe e shëndetshme.

2 → NDIHMONI NË PARANDALIMIN E MBIPOPULLIMIT TË KAFSHËVE NË RRUGË APO STREHIMORE

Duke adoptuar, ju ndihmoni në zvogëlimin e numrit të kafshëve të pastreha. Shumë kafshë në Kosovë braktisen çdo vit në rrugë apo para strehimoreve, dhe ju mund të kontribuoni në zvogëlimin e numrit të kafshëve të pastreha në rrugë. Për më tepër, adoptimi i një kafshe nga një qendër strehimi jo vetëm që do të thotë se po i jepni asaj një jetë të lumtur, por gjithashtu lironi një vend në strehimore për të shpëtuar jetën e një kafshe tjetër.

3 → NUK I MBËSHTETNI QENDRAT MBARËSHTUESE DHE TREGTINË ILEGALE

Shumë qen detyrohen të shumohen sa më shpesh që është e mundur dhe mbahen në kushte mizore në fermat e këlyshëve. Qentë jetojnë në kushte jo higjienike, pa ushqim të mirëfilltë, ujë ose kujdes veterinar të mjaftueshëm. Qentë femra mbarështohen me pak ose aspak kohë rikuperimi midis lindjeve. Duke zgjedhur të adoptoni, ju shmangni këto qendra mbarështuese dhe nuk kontribuoni në abuzimin e kafshëve.

Tregtia ilegale e kafshëve shoqëruese është një industri në rritje që fiton para nga keqtrajtimi i kafshëve, duke shmangur në të njëjtën kohë pagimin e taksave.

4 → KOSTO TË ULËTA FINANCIARE

Adoptimi i një kafshe nga strehimorja kushton shumë më pak se sa të bleni një qen apo mace nga një kultivues ose dyqan kafshësh. Duke qenë se praktikisht të gjitha strehimoret ofrojnë trajtime mjekësore veterinarë për kafshët nën kujdesin e tyre (vaksinimi, kastrimi/sterilizimi, trajtimi kundër parazitëve të brendshëm dhe të jashtëm, regjistrimi i kafshës), kjo do t'ju kursejë kohë dhe para.

5 → PËRMIRËSON JETËN E TYRE DHE TUJËN

Adoptimi nuk ka benefite vetëm për kafshët, por edhe për njerëzit. Studimet tregojnë që mbajtja e kafshëve shoqëruese mund t'ju ndihmojë të jetoni më gjatë, duke përmirësuar lumturinë dhe shëndetin tuaj të përgjithshëm.

